



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



Këshilli Gjyqësor i Kosovës,

Në mbështetje të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 pika 1.24 dhe nenit 17 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 63 paragrafi 2 dhe neni 65 paragrafi 3 të Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 29 i Rregull-it Financiar Nr.01/2013/MF - Shpenzimi i Parave Publike, si dhe nenit 30 paragrafi 1 të Rregullores Nr.03/2020 mbi Organizimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 21 dhjetor 2023,

Miraton:

UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr.04/2023

**PËR PROCEDURAT E PËRDORIMIT DHE MENAXHIMIT TË PARAVE
TË IMËTA PËR GJYKATA DHE NJËSITË E KËSHILLIT GJYQËSOR TË
KOSOVËS**

Neni 1
Qëllimi dhe fushëveprimi

Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave dhe procedurave për përdorimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e parave të imëta (petty cash) nga të gjitha gjykatat e Republikës së Kosovës, Sekretariati dhe Njësia për Inspektim Gjyqësor në Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Neni 2
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë udhëzim administrativ kanë këtë kuptim:

- 1.1. **Ligji** - Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë;
- 1.2. **Këshilli** - Këshillin Gjyqësor të Kosovës, ashtu siç përcaktohet me Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;
- 1.3. **Sekretariati** – Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ashtu siç përcaktohet me Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;
- 1.4. **Njësia** – Njësia për Inspektim Gjyqësor, ashtu siç përcaktohet me Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;
- 1.5. **DBF** - Departamenti për Buxhet dhe Financa në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- 1.6. **ZBF** – Zyra për Buxhet dhe Financa në gjykata;
- 1.7. **SIMFK** – Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës;
- 1.8. **ZKA** – Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit si Zyrtaari Kryesor Administrativ, ashtu siç përcaktohet me Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;
- 1.9. **Paratë e imëta** - janë fond i vogël i parave (petty cash) që mbahet në përkujdesjen dhe kontrollin e gjykatave, Sekretariatit dhe Njesisë, që shfrytëzohen për blerjet e ndryshme me vlera të vogla nën njëqind (100) € të cilat paraqiten në raste të paparashikueshme.

2. Shprehjet e përdorura në njëjës e kanë të njëjtin kuptim edhe në shumës. Fjalët e përdorura në një gjini përfshijnë edhe gjininë tjetër.

Neni 3 **Shfrytëzimi i parave të imëta**

1. Paratë e imëta shfrytëzohen:

- 1.1. për blerjet e ndryshme me vlera të vogla të cilat paraqiten në raste të paparashikueshme.

2. Paratë e imëta nuk mund të shfrytëzohen për:

- 2.1. shpenzimet që mund të bëhen praktikisht përmes procesit të rregullt të shpenzimeve;
- 2.2. pagesat e komunalive;
- 2.3. mallrat ose shërbimet me vlerë totale të kombinuar jo më shumë se njëqind (100) €;
- 2.4. të gjitha pagesat për të punësuarit apo për përfitimin e tyre personal, etj.

3. Gjykatat, Sekretariati dhe Njësia nuk mund të pranojnë fatura të shumëfishta nga një furnitor për të zvogëluar shumën e faturave individuale në më pak se njëqind (100) €, me qëllim të realizimit të një pagese.

Neni 4
Shuma e avanseve për para të imëta

Shuma e njehershme e tërheqjes së parave të imëta për programet buxhetore të Këshillit, sipas rregullave dhe procedurave të Thesarit është maksimum pesëqind (500) €. Me kërkesë dhe arsyetim nga Këshilli, thesari mund të lejoj rritje të limitit për programet buxhetore të Këshillit, përkatësisht për gjykata, Sekretariatit dhe Njësinë.

Neni 5
Kompetencat dhe përgjegjësit e Sekretariatit

1. Sekretariati ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

- 1.1. sigurimin e shumës së parave të imëta për gjykata, Sekretariatit dhe Njësinë;
- 1.2. caktimin e zyrtarit për tërheqjen dhe kthimin e avansit të parave të imëta nga banka;
- 1.3. ofrimin e ndihmës profesionale për zbatimin e procedurave për menaxhimin e parave të imëta;
- 1.4. mbylljen e avansit të parave të imëta.

2. Sekretariati tërheq parat e imëta të gjykatave, çdo herë në rast të konstatimit të parregullsive eventuale, siç janë por nuk kufizohen në keqpërdorime, vjedhje, blerja e palejuar dhe ndarja e faturave.

Neni 6
Kompetencat dhe përgjegjësit e ZKA-së

1. ZKA ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

- 1.1. cakton zyrtarin për mbajtjen e avansit për para të imëta;
- 1.2. autorizon dhe aprovon kërkesat për shpenzim;
- 1.3. mbikëqyrë, kontrollon dhe aprovon shpenzimin dhe mbajtjen e shënimeve për para të imëta për tu siguruar që çdo blerje është bërë sipas këtij udhëzimi dhe rregullave të Thesarit.

2. ZKA mund ti delegojë kompetencat tek përgjegjësit tjerë.

3. Sipas delegimit nga ZKA, administratori i gjykatës/ndihmës administratori i degës ka kompetenca dhe përgjegjësi të njëjta sipas nenit 6, përveç paragrafit 2 të këtij neni.

Neni 7
Kompetencat dhe përgjegjësit e zyrtarit për para të imëta

1. Zyrtari për para të imëta ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

- 1.1. është përgjegjës për pranimin dhe për sigurinë e fondit, për procedimin e pagesave nga ky fond, për barazim me Thesarin dhe për rimbushje apo mbyllje të fondit për para të imëta;
- 1.2. i mban paratë e imëta në një sef dhe nuk i lëshon ato fonde duke ju ndaluar dhe kufizuar qasje zyrtarëve tjerë përveç nëse merret autorizimi i duhur;
- 1.3. pranon kërkesën për shpenzime nga parat e imëta të autorizuar ose të aprovuar nga ZKA/zyrtari autorizues i gjykatës/degës si dhe plotëson dhe mbanë fletëpranimin si dëshmi për marrje-dhënie të mjeteve nga fondi i parave të imëta;
- 1.4. paguan faturat e dorëzuara për shpenzimet që janë të autorizuar ose të aprovuar paraprakisht nga ZKA/zyrtari autorizues i gjykatës/degës;
- 1.5. pranon faturën origjinale e cila përveç elementeve (të dhënave) obligative që duhet t'i përmbajë një faturë, duhet të ketë edhe emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e blerësit;
- 1.6. mban evidencë për të gjitha pagesat nga parat e imëta duke i regjistruar dhe klasifikuar në kodin përkatës sipas strukturës së planit kontabël;
- 1.7. barazon shumat e fondit në evidencën tabelore e cila evidencë (tabela) para rimbushjes apo mbylljes së avansit për para të imëta nënshkruhet nga zyrtari për para të imëta dhe i dërgohet për nënshkrim ZKA/zyrtarit autorizues të gjykatës/degës;
- 1.8. mjetet e pa shpenzuara zyrtari i parave të imëta i gjykatës/degës i kthen në Sekretariat së bashku me kopjen e dokumentacionit për mbyllje të fondit të parave të imëta, ndërsa kthimin e mjeteve në bankë për gjykata, për Sekretariat dhe Njësinë, e bënë zyrtari i parave të imëta i Sekretariatit;
- 1.9. zyrtari i parave të imëta i gjykatës/degës dhe ai i Sekretariatit bëjnë mbylljen e parave të imëta për gjykata, Sekretariat dhe Njësi sipas rregullave dhe procedurave në fuqi të Thesarit.

Neni 8

Ndërrimi i zyrtarit për para të imëta

1. Në rast të konstatimit të parregullsive, keqpërdorimeve apo rrethanave të tjera të arsyetuara zyrtari për para të imëta në gjykatë/degë mund të ndërrohet me vendim nga zyrtari autorizues i gjykatës/degës (administratori/ndihmës administratori i gjykatës), ndërsa zyrtari për para të imëta në Sekretariat dhe Njësi me vendim nga ZKA.

2. Zyrtari që ndërrohet/largohet duhet të dorëzoj bilancin e mbetur dhe evidencën tabelore së bashku me faturat. Dorëzim/pranimi duhet të bëhet me shkrim nga zyrtari që dorëzon dhe zyrtari që e pranon sipas vendimit nga ZKA apo nga zyrtari autorizues i gjykatës/degës.

Neni 9

Zbatimi

Për zbatimin e drejt dhe efikas të këtij Udhëzimi Administrativ për gjykata, do të përkujdeset ZBF në gjykatë dhe administratori/ndihmës administratori i gjykatës/degës, ndërsa për Sekretariat dhe Njësi, DBF dhe ZKA.

Neni 10
Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi administrativ, shfuqizohet Udhëzimi Administrative (Nr. 07/2014) për Rregullat e Përdorimit të Fondit të Parave të Imëta nga Gjykata dhe Udhëzimi Administrativ (Nr.08/2014) për Rregullat e Përdorimit të Fondit të Parave të Imëta nga Njësitë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, si dhe të gjitha aktet të tjera të miratuara në Këshill, që bien në kundërshtim me këtë udhëzim administrativ.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi ditën e miratimit të tij nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.


Albert Zogaj,

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Datë: 28. 12. 2023